



Република Северна Македонија

Republika e Maqedonisë së Veriut

СУДСКИ СОВЕТ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
KËSHILLI GJYQËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Ул. "Македонија" бр.5, 1000 Скопје | тел.02/3218 130 факс.02/3218 131 | contact@ssrm.mk

Rr. "Makedonija" nr.5, 1000 Shkup | tel.02/3218 130 faksi.02/3218 131 | contact@ssrm.mk

Në bazë të nenit 105 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, nenit 41 dhe nenit 46 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010, 83/18, 198/18 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 96/19), nenit 49 dhe nenit 50 paragrafi 1 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 102/2019), Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më datë 15.11.2023, miratoi:

VENDIM

PËR ZGJEDHJEN E GJYKATËSIT TË GJYKATËS SË APELIT SHKUP
për fushën Penale

Gjykatës i Gjykatës së Apelit Shkup për fushën penale është zgjedhur:

Osman Shabani – gjykatës i Gjykatës Themelore Penale Shkup.

Ky vendim do të hyjë në fuqi pas mbarimit të plotfuqishëm të procedurës dhe do të botohet në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

ARSYETIM

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut shpalli konkurs për zgjedhje të 8 (tetë) gjykatësve në Gjykatën e Apelit Shkup nga të cilët 4 (katër) gjykatës për fushën penale dhe 4 (katër) gjykatës për fushën civile, të botuar në ("Gazetën zyrtare të RMV-së" nr. 154/21 nga 08.07.2021).

Në konkursin e shpallur për zgjedhje të gjykatësve të Gjykatës së Apelit Shkup për fushën penale janë paraqitur gjithsej 34 kandidatë.

Procedurën për zgjedhje të gjykatësve të Gjykatës së Apelit Shkup, Këshilli e zbatoi në pajtim me Ligjin për gjykatësit, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rregulloren për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në

pajtim me Rregulloren për mënyrën e rangimit të kandidatëve për zgjedhje të gjykatësit në gjykatë më të lartë, Këshilli formon Komisioni i cili kontrollon dorëzimin në kohë të fletëparaqitjeve dhe plotësinë e dokumenteve të kandidatëve për konkursin. Me zbatimin e Metodologjisë për vlerësim të punës së gjykatës është realizuar vlerësim i jashtëzakonshëm i punës së kandidatit të zgjedhur, është realizuar tekst i psikologjisë dhe integritetit, e në pajtim me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për gjykatësit ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 150/10) për kandidatët që janë zgjedhur gjykatës para datës 26.11.2010 nuk bëhet kontrolli i punës praktike me kompjuterë, me ç'rast kontrolli i tillë për kandidatët nuk është realizuar.

Komisioni i formuar nga Këshilli Gjyqësor i RMV-së pas procedurës së zbatuar në pajtim me Rregulloren për mënyrën e rangimit të kandidatëve për zgjedhje të gjykatësit në gjykatë më të lartë bëri rangiminnë bazë të kriterëve të parapara në nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së, me ç'rast janë dhënë pika për aspektet e parapara të kriterëve dhe është përpiluar ranglistë e kandidatëve, në të cilën kandidatët me pika më të larta janë ranguar në vendin e parë. Pas ankesave të parashtruara për rangimdorëzuar Komisionit, Këshilli vendosi në seancë, pas së cilës Komisioni dorëzoi Raport me ranglistë finale të kandidatëve për zgjedhje të gjykatësve të Gjykatës së Apelit Shkup:

RANGLISTA E KANDIDATËVE
për zgjedhjen e 4 (katër) gjykatësve të Gjykatës së Apelit Shkup
për fushën penale

Nr. rend.	Emri dhe mbiemri i kandidatëve	Gjykatës i	pikë
1.	Llazar Nanev	Gjykatës Themelore Kavadar	77,2
2.	Gabriella Gajdova	Gjykatës Themelore Veles	76,4
3.	Ola Ristova	Gjykatës Themelore Penale Shkup	74,8
4.	Betim Jahja	Gjykatës Themelore Tetovë	68,9
5.	Aleksandra Risteska	Gjykatës Themelore Penale Shkup	66,8
6.	Daniella Aleksovska Stojanovska	Gjykatës Themelore Penale Shkup	66,6
7.	Verka Kostovska	Gjykatës Themelore Tetovë	65,2
8.	Ljubomir Gjorgeviq	Gjykatës Themelore Kumanovë	64,3
9.	Ljubinka Bashevaska	Gjykatës Themelore Penale Shkup	63,6
10.	Vesna Dimishkova	Gjykatës Themelore Penale Shkup	62,7
11.	Ivica Stefanovski	Gjykatës Themelore Penale Shkup	59,1
12.	Osman Shabani	Gjykatës Themelore Penale Shkup	59,1
13.	Ilija Tërpkov	Gjykatës Themelore Penale Shkup	57,5
14.	Sofçe Gavrillova Efremova	Gjykatës Themelore Penale Shkup	57,4
15.	Dijana Gruevska Ilievska	Gjykatës Themelore Penale Shkup	57,3
16.	Lenka Davitkova	Gjykatës Themelore Penale Shkup	54,9
17.	Biljana Kizhevaska	Gjykatës Themelore Kërçovë	53,9
18.	Xheneta Bektoviq	Gjykatës Themelore Penale Shkup	52,6
19.	Baki Aliu	Gjykatës Themelore Kërçovë	52
20.	Pajazit Pajaziti	Gjykatës Themelore Penale Shkup	51,6

21.	Vaska Nikolovska Masevska	Gjykatës Themelore Penale Shkup	51,4
22.	Dushan Josifov	Gjykatës Themelore Penale Shkup	50,3
23.	Marin Stanevski	Gjykatës Themelore Penale Shkup	49
24.	Gazmend Fezulli	Gjykatës Administrative	44,1

Në pajtim me nenin 49 paragrafi 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut është paraparë se gjykatës është zgjedhur kandidati i cili ka fituar së paku tetë vota nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote. Në nenin 50 paragrafi 1 të ligjit të njëjtë është paraparë se Këshilli zgjedh gjykatës dhe kryetar të gjykatës themelore dhe gjykata e apelit që gjendet në rajonin e njësisë së vetëqeverisjes lokale ku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, vendos në pajtim nenin 49 të këtij ligji, me ç'rast doemos duhet të ketë shumicë votash nga anëtarët e pranishëm që u përkasin komuniteteve në të cilat nuk janë shumicë në RMV. Në pajtim me nenin 23 paragrafi 3 të Rregullores për punën e Këshillit Gjyqësor të RMV-së është paraparë se nëse kandidati i ranguari parë në listë gjatë votimit nuk e fiton numrin e nevojshëm të votave, votohet për kandidatët e tjerë sipas radhitjes nga ranglista.

Në seancën e mbajtur më datë 15.11.2023, Këshilli Gjyqësor diskutoi lidhur me kandidatët për zgjedhje të gjykatësve dhe anëtarëte Këshillit u prononcuan për shkaqet për të cilat e japin votën e tyre, e që janë shënuar në procesverbalin e seancës së lartshënuar, pas së cilës Këshilli votoi për ranglistën.

Kandidati i parë nga ranglista Llazar Nanev me 4 vota "pro" dhe 8 vota "kundër" nuk e fitoi shumicën e nevojshme nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote, me ç'rast vijoi sipas radhitjes me kandidatin e dytë.

Kandidati i ardhshëm nga ranglista Gabriella Gajdova me 12 vota "pro" e fitoi shumicën e nevojshme nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote në pajtim me nenin 49 paragrafi 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së. Me 5 vota "pro" kandidati fitoi edhe shumicë votash nga anëtarët e pranishëm që u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me nenin 50 paragrafi 1 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së.

Kandidati tjetër nga ranglista Ola Ristova me 8 vota "pro" dhe 4 vota "kundër" e fitoi shumicën e nevojshme nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote, në pajtim me nenin 49 paragrafi 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së. Me 2 vota "pro" dhe 3 vota "kundër" kandidati nuk fitoi shumicën e votave nga anëtarët e pranishëm që u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Duke pasur parasysh se në nenin 50 paragrafi 1 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor është paraparë se për zgjedhje të gjykatës të gjykatës së apelit që gjendet në rajonin e njësisë së vetëqeverisjes lokale ku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, doemos

duhet të ketë shumicë votash nga anëtarët e pranishëm që u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e meqë kandidati nuk e fitoi shumicën e nevojshme të votave nga anëtarët e pranishëm që u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në RMV, vijoi sipas radhitjes kandidati tjetër nga ranglista për zgjedhje të gjykatësve.

Kandidati tjetër nga ranglista Betim Jahja me 7 vota “pro” dhe 5 vota “kundër” nuk e fitoi shumicën e nevojshme nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

Kandidati tjetër nga ranglista Aleksandra Risteska me 9 vota “pro” dhe 2 vota “kundër” e fitoi shumicën e nevojshme nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote, në pajtim me nenin 49 paragrafi 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së. Me 4 vota “pro” dhe 1 votë “kundër” kandidati fitoi edhe shumicë votash nga anëtarët e pranishëm që u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në pajtim me nenin 50 paragrafi 1 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së.

Kandidati nga ranglista Daniella Aleksovska Stojanovska me 5 vota “pro” dhe 7 vota “kundër” nuk e fitoi shumicën e nevojshme nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

Kandidati nga ranglista Verka Kostovska me 4 vota “pro” dhe 8 vota “kundër” nuk e fitoi shumicën e nevojshme nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

Kandidati nga ranglista Ljubomir Gjorgjeviq me 4 vota “pro” dhe 8 vota “kundër” nuk e fitoi shumicën e nevojshme nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

Kandidati nga ranglista Ljubinka Basheska me 3 vota “pro” dhe 9 vota “kundër” nuk e fitoi shumicën e nevojshme nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

Kandidati tjetër nga ranglista Vesna Dimishkova me 11 vota “pro” dhe 1 votë “kundër” e fitoi shumicën e nevojshme nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote, në pajtim me nenin 49, paragrafi 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së. Me 4 vota “pro” dhe 1 votë “kundër” kandidati fitoi edhe shumicë votash nga anëtarët e pranishëm që u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në pajtim me nenin 50 paragrafi 1 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së.

Kandidati nga ranglista Ivica Stefanovski me 6 vota “pro” dhe 6 vota “kundër” nuk e fitoi shumicën e nevojshme nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë Vote.

Kandidati tjetër nga ranglista Osman Shabani me 11 vota “pro” dhe 1 votë “kundër” e fitoi shumicën e nevojshme nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote, në pajtim me nenin 49 paragrafi 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së. Me 5 vota “pro” kandidati fitoi edhe shumicë votash nga anëtarët e pranishëm që u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në pajtim me nenin 50 paragrafi 1 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së.

Çdo anëtar i Këshillit me të drejtë vote, dha arsyetim për vendimin e tij për zgjedhje të gjykatësit siç është paraparë në nenin 49 paragrafi 3 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kandidati Osman Shabani ka stazh të përgjithshëm të gjykatësit prej 11 vite deri në ditën e paraqitjes në konkursin. Si gjykatës ka punuar në materie penale, në krimin e organizuar dhe materien për kundërvajtje, dhe gjatë vlerësimit të jashtëzakonshëm për dy vite është vlerësuar me vlerësim pozitiv. Sipas arsytimit të dhëna nga anëtarët e Këshillit delse bëhet fjalë për gjykatës me përvojë shumëvjeçare, profesional dhe të përgatitur, me integritet i cili vepron për lëndë më të ndërlikuara në shtet – krim të organizuar, me vendime që karakterizohen me cilësi, kështu që me angazhimin e tij si gjykatës në krimin e organizuar do të japë kontribut të madh në tejkalimin e problemit me saktësinë në gjykatën e apelit për këto lëndë.

Duke e pasur parasysh të lartpërmendurën, Këshilli e zgjedh Osman Shabanin gjykatës të Gjykatës së Apelit Shkup, për fushën penale.

Nr. 09-2295/1
17.11.2023
Shkup

